



RREGULLORE E BRENDSHME PËR DISIPLINË NË SHKOLLË

DISPOZITATE PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

Shkolla "Gjimnazi Britanik për Teknologji SH. P. K." është themeluar si biznes me përgjegjësi të kufizuara në përputhje me dispozitat e statutit të biznesit. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i disiplinës në shkollë.

Neni 2 - Fushëveprimi

2.1 Kjo rregullore për disiplinë ka për qëllim të përcaktojë të drejtat, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim dhe masat e procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve të cilët i shkelin rregullat e kodit të mirësjelljes. Ajo merr parasysh kushtet e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe udhëzimin administrativ të MASHT-it nr. 06/2014.

2.2 Përmes kësaj rregullore, nxënësit do të kuptojnë se çka është e lejuar dhe çka është e ndaluar gjatë orarit mësimor dhe gjatë kohës sa nxënësit gjenden në hapësirat e shkollës, si dhe masat që do të ndërmerren me rastin e shkeljes së kësaj rregullore.

2.3 Rregullorja e disiplinës së shkollës është e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe prindërit. Cilido, sipas detyrës dhe kompetencave të veta, duhet të ndihmojnë që rregullat të zbatohen me ndershmëri dhe rigorozitet.

Neni 3 – Të drejtat e nxënësve

- 3.1 E drejta për shkollim sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve të shtetit dhe rregullave të përcaktuara nga Shkolla.
- 3.2 E drejta për shkollim të drejtë pa asnjë formë të diskriminimit të etnik, religjioz, gjinor apo të statusit social dhe ekonomik
- 3.3 Të kenë siguri ambientale dhe shëndetësore gjatë qëndrimit në ambientet shkollore dhe në aktivitetet e organizuara jashtë objekteve shkollore;
- 3.4 Të marrin pjesë në aktivitetet e lira të nxënësve (lëndore-shkencore, kulturore-artistike, sportive-rekreative dhe tekniko-ekonomike);
- 3.5 Të shfrytëzojnë bibliotekën e shkollës. Ta ruajë, ta lexojë dhe ta kthejë me kohë e të padëmtuar librin e huazuar, në pajtim me rregullat dhe orarin e punës së bibliotekës.
- 3.6 Të shfrytëzojnë pushimet mes orëve të mësimit për pushim, freskim dhe aktivitete tjera që nuk bien ndesh me këtë rregullore;
- 3.7 Në rast nevojë dhe me arsye, të kërkojnë leje për mungesë të përkohshme nga ora e mësimit apo ndonjë ditë mësimi, në bazë të kërkesës së arsyeshme të bërë nga vetë prindi, (nëse është në dobi të nxënësit). Drejtori i shkollës mund t'i jap leje nxënësit të mungojë deri dy javë mësimi , kur prindi e arsyeton një gjë të tillë.
- 3.8 Të arsimohen sipas aftësive dhe prirjeve individuale e kolektive të tyre. T'u zhvillohet talenti dhe prirjet përmes stimulimit, jo vetëm në lëndët obliguese, por edhe në aktivitete të lira dhe jashtë planprogrameve shkollore.
- 3.9 Të kërkojnë nga mësimitdhënësit punimet e tyre me shkrim; provimet, hartimet, testet e bëra me shkrim, vizatimet etj., me qëllim që t'i analizojnë, apo të reflektojnë për to, në mënyrë që nxënësit ti shfaqin përshtypjet e tyre se a janë të kënaqur apo jo me vlerësimin (notimin) e atij punimi;
- 3.10 Në rast pakënaqësie me cilësinë e paraqitjes së mësimitdhënies, vlerësimin jo sa duhet bindës para nxënësit, sjelljen jo korrekte dhe të qëllimshme, nxënësi përmes kujdestarit të klasës dhe të prindit të tyre, mund të bëjë ankesë, gjegjësisht ta sensibilizojë çështjen te drejtori i shkollës.

3.11 Nxënësit e dalluar në bazë të suksesit të dëshmuar gjatë vitit, do të pajisen me lëvdata publike dhe me mirënjohje nga drejtori i shkollës në një ceremoni të veçantë.

Neni 4 – Obligimet e nxënësit

4.1 Paraqitja në mësim sipas orarit shkollor është e detyrueshme për të gjithë.

4.2 Pushimi i shkurtër apo pushimi mes orëve shërben për nxënësit vetëm për t'i kryer nevojat personale dhe për të shkuar në sallën që ka mësim në orën e ardhshme.

4.3 Të jetë i përgatitur për orën e mësimin, t'i kryejë detyrat e shtëpisë dhe të jetë i disiplinuar;

4.4 Të jetë i pajisur me tekste shkollore dhe me mjete tjera të domosdoshme (pajisjet që ua ka dhuruar shkolla) për mësim, punë praktike, aktivitete të lira etj.;

4.5 Nxënësit që mungojnë në shkollë do të futen në klasë vetëm pas justifikimit të arsyetuar të prindit ose të një kujdestari që e zëvendëson atë. Arsyetimi i mungesave duhet të bëhen në kohën e duhur;

4.6 Mungesat për arsye shëndetësore, justifikohen vetëm me raport mjekësor tek kujdestari i klasës jo më larg se 48h;

4.7 Vonesat e shpeshta do t'u njoftohen familjeve dhe do të kenë masa disiplinore;

4.8 Gjatë kohës së mësimin duke përfshirë edhe pushimet, asnjë nxënës nuk duhet të dale nga shkolla pa leje të drejtorisë, dhe shkolla nuk e lejon të dale nxënësin nga shkolla pa lejen e prindit.

4.9 Nxënësi mund të dalë nga shkolla vetëm pas kërkesës së prindit tek drejtorja e shkollës. Pranimi i kërkesës së prindit nga drejtorja e shkollës, i heq shkollës çdo përgjegjësi që nga momenti që nxënësi del nga shkolla;

4.10 Nga të gjithë kërkohet një qëndrim korrekt dhe i edukuar;

4.11 Ti ruaj pajisjet që ua ka dhuruar shkolla, inventarin dhe pasurinë e shkollës;

4.12 Të respektojë integritetin e personalitetit të secilit anëtar të personelit të Institucionit të arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP);

- 4.13 Ta mbaj uniformën e shkollës gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale;
- 4.14 Nxënësi pas mbarimit të mëimit, mund të jetë i pranishëm në shkollë vetëm në aktivitete të organizuara nga përgjegjësit e shkollës, ose për shkak të orëve plotësuese që mund t'i ketë në lëndët e caktuara;
- 4.15 Të kujdesët për mbajtjen e higjienës dhe rendit shtëpiak në klasë. Përgjegjës janë të gjithë nxënësit, e në veçanti nxënësit kujdestar të javës.
- 4.16 T'i ruaj me kujdes gjësendet personale. Shkolla nuk garanton dhe nuk merr përgjegjësi për humbjen e gjësendeve gjatë qëndrimit të nxënësve në shkollë.

Neni 5 – Veprimet e ndaluara

- 5.1 Mungesa e paarsyeshme nga Institucioni i arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP);
- 5.2 Mbajtja e armëve të ftohta dhe të zjarra si dhe mjeteve të tjera që e rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit të shkollës;
- 5.3 Veprimet e dhunshme si kërcënimi, konflikti, vandalizmi, mosrespektimi, fyerja ndaj nxënësve dhe personelit në shkollë dhe jashtë saj;
- 5.4 Shkarravitja, dëmtimi dhe mbishkrimi i mureve, dyerve, dritareve dhe inventarit të shkollës;
- 5.5 Ndalohet rreptësisht për të gjithë bartja dhe konsumimi i drogës, duhanit dhe alkoolit në ambientet shkollore;
- 5.6 Hyrja me vonesë në orë mësimi ose praktikë profesionale;
- 5.7 Në mjediset e shkollës nuk lejohen zhurma, shprehjet e pahijshme, çrregullimet, lojërat e papërshtatshme dhe dëmtimet e bazës material të shkollës;
- 5.8 Lëshimi i orës së mëimit apo të Praktikës profesionale pa lejen e mësimdhënësit, punëdhënësit;
- 5.9 Ndalohet përdorimi i telefonave celular gjatë orarit mësimor për nxënësit. Nxënësi mund të kontaktojë me familjen e tyre duke u paraqitur në drejtori në çfarëdo kohe;

- 5.10 Qasja, bartja dhe keqpërdorimi i ditarit të klasës;
- 5.11 Falsifikimi i nënshkrimit të prindërve, dokumentacionit të shkollës dhe i çfarëdo dokumentacioni që i dedikohet shkolles;
- 5.12 Kopjimi gjatë testeve apo provimeve me shkrim të organizuara nga stafi i shkollës;
- 5.13 Nxënësit janë përgjegjës për dëmtimin dhe prishjen e pajisjeve që i përkasin shkollës, po ashtu pajisjet që shkolli ua ofron nxënësve. Kush dëmton paguan. Drejtoria nuk përgjigjet për sendet vetjake që nxënësit sjellin dhe i harrojnë në shkollë (veshje, libra, para, etj.);
- 5.14 Veshjet ekstravagante dhe grim i tepruar;
- 5.15 Nxitja dhe pjesëmarrja në rrahje në shkollë dhe jashtë saj;
- 5.16 Ndotja e ambientit shkollor dhe hapësirave përreth shkollës;
- 5.17 Sjellja asociale-devijuese si publikimi i videove, fotove dhe gjerave të tjera në internet, ku nënçmohen nxënësit dhe personeli i shkolles sone, cilësohet si veper e rende.
- 5.17 Sjellje tjera asociale-devijuese që drejtori i shkollës, Këshilli i klasave dhe Këshilli i arsimtarëve i cilësojnë si shkelje të rënda dhe sjellje të dëmshme për mbarëvajtjen e jetës dhe punës në shkollë.

Neni 6 – Vijueshmëria në mësim dhe praktikë profesionale

- 6.1 Nxënësi i cili mungon pa arsye 15 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në 3, kjo notë nuk mund të përmisohet më;
- 6.2 Nxënësi i cili mungon pa arsye 25 orë mësimi, i thyhet nota e sjelljes në 1, kjo notë nuk mund të përmisohet më;
- 6.3 Nxënësi i cili mungon pa arsye më shumë se 32 orë mësimi, i kontaktohet prindi dhe shkëputet kontrata mes prindit dhe institucionit.

Neni 7 – Masat edukativo-disiplinore

Për thyerjen e rregullave të disiplinës, veçanërisht për raste të rënda e të përsëritura do të merren masa të menjëhershme si më poshtë:

1. Vërejtje me gojë;
2. Vërejtje me shkrim;
3. Këshillim nga ana e psikologut të shkollës;
4. Pezullim i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet;
5. Qortim – këshillim nga ana e drejtorisë;
6. Pezullim i përkohshëm nga shkolla deri në 3 ditë;
7. Paralajmërim i familjeve;
8. Thyerja e notes së sjelljes;
9. Për thyerjen e rregullave të rënda të disiplinës, shkolla mund të vendos për shkëputjen e kontratës mes prindit dhe institucionit;

Neni 8 – Klasifimi i veprave në bazë të shkeljes

8.1 Shkelje të lehta të rregullave të shkollës konsiderohen:

1. Bartja e duhanit në hapsirat e shkolles;
2. Vonesa në orë të mësimi ose praktikë profesionale;
3. Zhurmat dhe pengimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor, shprehjet e pahijshme, çrregullimet, lojërat e papërshtatshme dhe dëmtimet e bazës material të shkollës;
4. Veshjet ekstravagante dhe grim i tepruar;
5. Ndotja e ambientit shkollor dhe hapësira përreth shkollës;
6. Shkarravitja, dëmtimi dhe mbishkrimi i mureve, dymve, dritareve dhe inventarit të shkollës, (prindi detyrohet ti paguaj çdo dëmtim të inventarit);
7. Përdorimi i telefonave celular gjatë orarit mësimor për nxënësit;
8. Ndotja e ambientit shkollor dhe hapësirave përreth shkollës;
9. Sjellje tjera asociale-devijuese që drejtori i shkollës dhe kujdestari i klasës i cilësojnë si shkelje të lehta dhe sjellje të dëmshme për mbarëvajtjen e jetës dhe punës në shkollë.

8.2 Shkelje të rënda të rregullave të shkollës konsiderohen:

1. Mbajtja e armëve të flohta dhe të zjarra si dhe mjeteve të tjera që e rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit të shkollës;
2. Bartja dhe konsumimi i drogës dhe alkoolit
3. Veprimet e dhunshme si kërcënimi, konflikti, vandalizmi, mosrespektimi, fyerja ndaj nxënësve dhe personelit në shkollë dhe jashtë saj;
4. Qasja, bartja dhe keqpërdorimi i ditarit të klasës;
5. Falsifikimi i nënshkrimit të prindërve, dokumentacionit të shkollës dhe i çfarëdo dokumentacioni që i dedikohet shkollës;
6. Kopjimi gjatë testeve apo provimeve me shkrim të organizuara nga stafi i shkollës.
7. Dëmtimi dhe prishja e pajisjeve që i përkasin shkollës, po ashtu pajisjet që shkolla ua ofron nxënësve.
8. Nxitja dhe pjesëmarrja në rrahje në shkollë dhe jashtë saj;
9. Bullizmi ndaj nxënësve të tjerë apo ndaj stafit të shkollës;
10. Sjellje tjera asociale-devijuese që drejtori i shkollës, Këshilli i klasave dhe Këshilli i arsimtarëve i cilësojnë si shkelje të rënda dhe sjellje të dëmshme për mbarëvajtjen e jetës dhe punës në shkollë.
11. Konsumimi i duhani në sallat e mësimit.

Për sjellje tjera të paparashikuara mblidhet një komision disiplinor i cili bënë vlerësimin e sjelljes së nxënësit konkret dhe i shqipton masën disiplinore për atë vepër.

Neni 9 – Komisioni disiplinor

9.1 Komisioni disiplinor formohet pasi të kryhet ndonjë vepër e cila nuk është paraparë në këtë rregullore dhe për klasifikimin e asaj vepre vendos ky komision.

9.2 Komisioni disiplinor përbëhet nga drejtori i shkollës, tre mësimitdhënës të cilët i propozon drejtori i shkollës dhe së paku një përfaqësues i prindërve.

9.3 Në komision nuk mund të marr pjesë ai mësuesi që ka patur ndonjë debat me nxënësin ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura, apo nëse vepra në fjalë është shkaktuar ndaj tij.

9.4 Me vendimin e komisionit disiplinor nxënësit mund t'i reduktohet kontrata nga tre vite në tre muaj, dhe pastaj kjo kontratë të vazhdohet çdo tre muaj në bazë të sjelljeve të nxënësit.

Neni 10 – Vërejtjet

10.1 Vërejtja me gojë i shqiptohet nxënësit i cili bën shkelje të lehta të rregullave të shkollës, kompetent për shqiptimin e kësaj mase është kujdestari i klasës.

10.2 Vërejtje me shkrim i shqiptohet nxënësit i cili bën përsëritje të shkeljeve të rregullave të shkollës deri në 3 (tri) herë. Këtë masë disiplinore e shqipton drejtori i shkollës me propozimin e kujdestarit të klasës. Nxënësi mund të marrë menjëherë vërejtje me shkrim në rast se bënë ndonjë shkelje më të rëndë.

10.3 Pëzullim i përkohshëm nga aktivitetet jashtëshkollore si garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, i shqiptohet nxënësit i cili me sjelljen e tij i pengon aktivitetet jashtëshkollore. Këtë masë disiplinore e shqipton kujdestari i klasës me propozimin e organizuesit të garës.

10.4 Qëndrimi një orë në shkollë pas mbarimit të mësimit për një ditë ose më shumë përveç orëve plotësuese bëhet kur nxënësi bënë shkelje të lehta të rregullave të shkollës, ose nëse në EduPage i ka tre kartona si paralajmërim nga profesori i lëndës apo kujdestari i ditës automatikisht i vendoset edhe kartoni i kuq. Nëse nxënësi i ka tre kartonë të kuq nga tre lëndë të ndryshme atëherë nxënësi humb pushimin një javor, në këtë rast nxënësi do të vij në shkollë gjatë këtij pushimi, varësisht sa ditë i caktohen.

10.5 Pëzullim nga shkolla deri në 3 (tri) ditë i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pas shqiptimit të vërejtjeve paraprake. Këtë masë e shqipton drejtori i shkollës me propozimin të kujdestarit të klasës.

10.6 Shkëputja e kontrates mes prindit dhe institucionit bëhet pasiqë nxënësi ka bërë shkelje të rënda të rregullores së shkollës.

10.7 Nxënësi pezullohet nga shkolla prej 3 (tri) ditë deri në 3 (tri) muaj nëse ka bërë shkelje të vazhdueshme apo të rënda të rregullave të shkollës.

Neni 11 – Procedura për zbatimin e masave

11.1 Iniciativën për të gjitha masat, e merr kujdestari i klasës ose udhëheqësi i aktivitetit jashtëshkollor.

11.2 Për të gjitha masat e marra duhet të njoftohet prindi dhe të merren informatat kthyesë se prindi është në dijeni.

11.3 Njoftohet edhe nxënësi.

11.4 Të gjitha masat duhet të shënohen në ditar dhe në procesverbal.

11.5 Masat e shqiptuara me shkrim publikohen në tabelat për shpallje.

Neni 12 - Hyrja në fuqi e rregullores

Kjo rregullore hyn në fuqi pas votimit nga këshilli drejtues dhe pas nënshkrimit nga ana e drejtorit të shkollës.

Drejtori i shkollës



The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "GJIMNAZI" in the center, "SPECIALIZIM PËR" below it, "TEKNOLOGJI" in a larger font below that, and "SKPK" at the bottom.

Prishtinë: 18.04.2023